



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

*Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. _____ **Prot.** _____
Nr. Dok. 202201346/5

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, për moskthim të përgjigjeve*

Drejtuar: **Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë**

Për dijeni: **Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

Tiranë

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, nisur nga ankesa e shtetasit S.Sh i cili ankohet lidhur me veprimet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, për regjistrimin e pronës në Jalë, Vlorë, ka filluar hetimin administrativ për verifikimin e rastit të paraqitur.

Fillimisht, me shkresën nr.K2/S16-2, datë 01.12.2022 kemi kërkuar informacion si në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, po ashtu edhe në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Shtetasi S.Sh është pronar i pasurive të trashëguara nga A.Sh, në bregdetin e Jalës të njohur me vendim nr.***, datë 31.03.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë.

Në vitin 2011 me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr.***, datë 11.02.2011 është vendosur çelja e trashëgimisë ligjore e cila është regjistruar në ZVRPP Vlorë.

Pas komunikimit shkresor me ZVRPP Vlorë dhe ZQRPP Vlorë z.Sh ka kërkuar regjistrimin e “aktit testamentar” të cilin posedon dhe fshirjen e emrave të trashëgimtarëve të tjerë. ZVRPP Vlorë dhe ZQRPP kanë kthyer përgjigje se në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 23.04.2010 për të regjistruar testamentin duhet t’i drejtohej gjykatës, vendimi i së cilës do të mundësonte çregjistrimin e aktit të trashëgimisë dhe regjistrimin e testamentit.

Kështu, shtetasi i është mohuar e drejta e regjistrimit të pronës nëpërmjet testamentit dhe për këtë arsye, ka çelur proces gjyqësor me objekt: “Detyrimin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në pronësi të paditësit S.Sh truall me sip.120m² dhe mure të shtëpisë mbi këtë truall në Jalë-Vuno, ZK.3844, me kufij: V-Përroi i Thatë L-Trualli i P.D, J.P-S.K, fituar me dëshmi testamentare nr.4599, datë 18.11.2002, duke konstatuar absolutisht të pavlefshme, pjesërisht dëshminë e trashëgimisë nr.319/11.02.2011, fshirjen e regjistrimit të bashkëpronarëve të tjerë, D.Sh, L.P.(Sh) refuzuar për regjistrim me përgjigjen nr.5352/1 prot., datë 23.10.2017 të ZVRPP Vlorë dhe 774/1 prot., datë 14.02.2018 të ZQRPP Tiranë.”

Me vendimin nr.172, datë 12.02.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është vendosur në favor të paditësit.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës e ka apeluar këtë vendim, po ashtu edhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.111/2018.

Konflikti është thelbësisht civil dhe nuk duhet të ketë arsye për ankim të vendimit gjyqësor nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Prona e cila ndodhet në juridiksionin territorial të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë gjendet në proces lidhur me aktin i cili sjell si pasojë regjistrimin e saj. Në çdo rast, për të dhënë mundësinë e sqarimit të rrethanave, kemi kërkuar shpjegime.

Në nenin 23 të ligjit nr.111/2018 “Për kadastrën” përcaktohet:

“1. Drejtoria vendore kadastrale regjistron:

a) titujt që ajo krijon nga veprimtaria në zbatim të legjislacionit për çështjet e pronësisë; b) titujt që krijohen nga veprimet juridiko-civile ndërmjet subjekteve të së drejtës private, nga vendimet gjyqësore, apo nga akte të organeve të tjera publike.

2. Drejtoria vendore, me aktin e regjistrimit dhe lëshimin e certifikatës, garanton formalisht titullin e pronësisë në favor të pronarit ose bashkëpronarëve. Më lëshimin e certifikatës, pronarit i lind e drejta për ta disponuar pronën lirisht, për aq sa ajo nuk ka barrë hipotekore.

3. Drejtoria vendore mund të ndryshojë përmbajtjen e regjistrit vetëm në rastet e mëposhtme:

a) me paraqitjen e një dokumenti noterial që konfirmon vullnetin e pronarit, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të legjislacionit në fuqi;

b) sipas përmbajtjes së vendimit gjyqësor;

c) kur është e nevojshme, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë;

ç) për korrigjimin e pasaktësive hartografike dhe gabimeve materiale;

d) për përmirësim-përditësimin e regjistrit;

dh) sipas një akti tjetër ligjor të detyrueshëm për regjistrim, sipas Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.”

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63/4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, si dhe nenit 19 /b të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”¹, në vijim të hetimit administrativ, me qëllim sqarimin e fakteve e

¹ “**Neni 19**

Procedura e hetimit

Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë:

a) të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton.

b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin;

c) të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet;

ç) të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

Neni 19/1

Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

të rrethanave, kemi kërkuar shpjegime lidhur me ankesën e shtetasit S.Sh dhe mundësinë për regjistrimin e pronës bazuar në testament.

Me shkresën nr.14693/9 prot., datë 27.12.2022 Agjencia Shtetërore e Kadastës i adresohet Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Vlorë si institucion përgjegjës, për zbatimin e procedurave të parashikuara në legjislacionin për çështjet e pronësisë, dhe trajtimin e shkresës së Avokatit të Popullit, duke verifikuar pretendimet e ngritura lidhur me ankesën e shtetasit z.S.Sh, bazuar në dokumentacionin e administruar në këtë drejtori, duke dhënë edhe një informacion të detajuar, me qëllim zbatimin e kërkesës, në përputhje me ligjin nr.111/2018 “Për kadastrën”.

Duke qenë se shkresa e Avokatit të Popullit, si dhe shkresa e mësipërme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nuk janë marrë në konsideratë, është dërguar një shkresë e dytë, nr.K2/S16-4, datë 03.05.2023, e cila po ashtu nuk ka marrë përgjigje. Pra, në mënyrë të përsëritur nuk është kthyer përgjigje, edhe pse ka kaluar afati i përcaktuar, si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër, ju bëjmë me dije se kjo situatë përbën shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, miratuar me ligjin nr.44/2015, duke moszbatuar dhe cenuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Mosdërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mostrajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e korrektesës së institucionit tonë ndaj ankuesit. Ky qëndrim i mbajtur nga organi juaj me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit.

Ndërkohë kjo sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Neni 63 përcakton se: “*Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. **Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij**”.*

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.”

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentat ligjore që kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63 pika 1, 2 dhe 3 e tij parashikojnë instrumenta të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozimi për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës. Gjithashtu, edhe ligji nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre.

Shprehimisht kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji në të cilin është parashikuar se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*.

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”. Neni 3 i këtij ligji përcakton se: *“Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjore që u janë besuar, në përputhje me ligjin”*.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijojnë shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka paraparë si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesa e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e

qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ, është një detyrim Kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Për gjithë sa paraqitëm më lart, evidentohet lehtësisht neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit të këtij institucioni, thjesht duke parë afatin apo datën kur kemi kërkuar informacion, që i përket datës 03.05.2023, ndërkohë akoma nuk kemi një përgjigje prej tij (5 muaj).

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Drejtoria Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, titullari i këtij institucioni, të vlerësojë në përputhje me ligjin **organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve, si dhe ofrimin e shërbimeve konform legjislacionit aktual.**

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”*,

REKOMANDOJMË:

- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përgjegjës, të Drejtorisë Vendore të Kadastrës Vlorë, lidhur me mospërmbushjen e detyrimit ligjor, për t’i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, dhe as të Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.

- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.
- Marrjen e masave për sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë Vendore të Kadastrës Vlorë me institucionin e Avokatit të Popullit, duke shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit dhe dokumenteve hetimore.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “ Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Në mungesë dhe me Urdhër

K O M I S I O N E R

AHMET PRENÇI